

VENDIM
Nr. 357, datë 20.5.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 497, DATË 27.7.2022, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN, VEPRIMTARINË
DHE RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT KOMBËTAR PËR
ZHVILLIMIN RAJONAL DHE KOHEZIONIN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 4, të nenit 17, të ligjit nr. 102/2020, “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 497, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin”, bëhen këto ndryshime:

1. Në kreun II bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. KKZHRK-ja drejtohet nga zëvendëskryeministri, në cilësinë e kryetarit.”;

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Përbërja e KKZHRK-së do të jetë e njëjtë me përbërjen e këshillit drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH). Anëtarë të KKZHRK-së janë anëtarët e këshillit drejtues të FSHZH-së, të emëruar sipas përcaktimeve të nenit 10, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar.”;

c) Pikat 4, 5 e 7 shfuqizohen.

2. Në kreun III bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 7, fjalët “... ose zëvendëskryetari” hiqen;

b) Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Në varësi të rendit të ditës, me propozim të kryetarit, mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e KKZHRK-së përfaqësues të institucioneve qendrore e vendore, përfaqësues nga bordet e monitorimit të zhvillimit rajonal (BMZHR), të ngritura në përputhje me ligjin nr. 102/2020, “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, përfaqësues të shoqatave të njësive të vetëqeverisjes vendore, përfaqësues të donatorëve, të institucioneve të Bashkimit Evropian ose aktorë të tjerë të zhvillimit rajonal.”.

3. Pikat 1 e 2, të kreut V, shfuqizohen.

II. Ngarkohen zëvendëskryeministri, Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, ministritë e linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi